KOSOVA SOT

E HËNË, 30 JANAR 2012, ÇMIMI 0.30 €, VITI XV, NR. 4459

E PËRDITSHME INFORMATIVE E PAVARUR

KOSOVA SOT gazeta Nr.1
Paanshmëri
Lexueshmëri
Besueshmëri
14 vjet

EDITORIALI

Telashe për Prizrenin

Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit vazhdon të shkaktojë debate të ashpra, jo vetëm në Kuvendin e Kosovës. Drafti ligjori për Qendrën Historike të Prizrenit parasheh më tepër fuqi juridike në administrimin e shumë pronave për Kishën Ortodokse në qendër të këtij qyteti.

Ky privilegj konsiderohet si diskriminues për qytetarët prizrenas, të cilët edhe dje kanë protestuar në sheshin "Shatërvan", me moton "Nuk e duam ligjin".

Përveç deputetëve që e kanë kundërshtuar këtë projektligj, një zë i fortë kundërshtues janë edhe organizatat e shoqërisë civile. Sipas tyre, nëse ligji miratohet, krijohen situata të reja favorizuese për një bashkësi të caktuar fetare, që në rastin konkret është ajo serbe. Kjo do të ishte diskriminuese për shqiptarët dhe komunitetet e tjera që jetojnë në Prizren. Kuvendi i Kosovës është vënë

INTERVISTË ME AMBASADOREN E TURQISË NË KOSOVË, SONGUL OZAN

Marrëdhënie vëllazërore TURQI - KOSOVË

"Turqia është ndër vendet e para që e njohu Kosovën. Sikur para pavarësisë, edhe pas shpalljes së saj, marrëdhëniet ndërmjet Turqisë dhe Kosovës janë duke u avancuar në vazhdimësi, në çdo fushë. Vizitat reciproke të niveleve të larta, marrëdhëniet tona tejet të zhvilluara ekonomike, tregtare, arsimore, kulturore, në çështjet e sigurisë e shëndetësisë, kontaktet e dendura ndërmjet politikanëve tanë, si dhe bashkëpunimet ndërmjet organizatave joqeveritare dhe universiteteve tona janë duke u zgjeruar dhe thelluar pandërprerë", thotë Songul Ozan, ambasadore e Turqisë në Kosovë, në intervistën për "Kosova Sot"

5

